



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2022:097067

Datë: 06.03.2023

Numri i dokumentit: 04049738

**C.nr. 279/2022**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. F. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P.”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **06.03.2023** merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

Padia e paditësit G. F. nga Prizreni, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

### **A r s y e t i m**

Paditësi G. F. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P.”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Gjykata me Aktvendimin C.nr. 279/2022 të datës 24.08.2022, e ka ftuar paditësin që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguaj taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datën 31.08.2022, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 parg. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 paragraf 5 lidhur me nenin 387 paragraf 1 pikë c) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,  
C.nr. 279/2022, me datë 06.03.2023.**

**Bashkëpunëtor profesional  
Samir Morina**

**GJYQTARI  
Besmir Juniku**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.